



Komiteti për Komunitete

02. Nr. I

Deçan, dt. 12.01.2024

PROCESVERBAL

Mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 12.01.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, PK-ja, OSBE, UNMIK-u.

Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës të këtij takimi.

Për mbledhje ishin propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raport nga ZLK;
3. Shqyrtimi, analiza dhe aprovimi i Raportit vjetor të punës dhe aktivitetit të Komitetit për Komunitete për vitin 2023.
4. Shqyrtimi, analiza dhe aprovimi i planit të punës për vitin 2024.
5. Të ndryshme:

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Procesverbali miratohet një zëri pa asnjë vërejtje nga të gjithë anëtarët e Komitetit..

II. Raporti i ZLK-së:

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinović, Udhëheqës i ZLK-së, raportoj për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve. Ai tha se zyra që udhëheq ai, gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar.

III. Shqyrtimi, analiza dhe aprovimi i Raportit vjetor të punës dhe aktivitetit të Komitetit për Komunitete për vitin 2023:

Sa i përket Raportit Vjetor të Punës dhe aktivitetit të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, pas shqyrtimit i njëjti u aprovua njëzëri.

IV. Sa i përket shqyrtimit, analiza dhe aprovimi i planit të punës për vitin 2024 i njëjti u aprovua njëzëri.

Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-ja propozoj që këtë vit Komiteti për Komunitete të raportoj dy (2) here në vit para Kuvendit Komunal rreth aktivitetit të Komiteti për Komunitete.

V. Të ndryshme:

Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-ja kërkoj të njoftohet se çka ka ndodh me kërkesën për ndihmë financiare për familjen Çekiçi dhe me rastet e braktisjes së shkollimit nga fëmijët e kësaj familje.

Kryesuesi z, Shkelzen Berisha i njoftoj te pranishmit se kërkesa për familjen Çekiçi është dorëzuar KPF-së, ndërsa sa u rasteve të braktisjes se shkollimit nga fëmijët e kësaj familje të njëjtit disa here janë kthye në shkollë dhe prapë e kanë braktis shkollimin gjë që përsëritet në vazhdimësi.


Kryesuesi i falënderoi të pranishmit dhe shpalli mbledhjen të mbyllur.

Procesmbajtësi:
Artan Ismajlaj



Kryesuesi i mbledhjes
Shkelzen Berisha





Komiteti për Komunitete
02. Nr. II
Deçan, dt. 16.02.2024

PROCESVERBAL

Mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 16.02.2024.
Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u.
Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës të këtij takimi.

Për mbledhje ishin propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raport nga ZLK;
3. Informim nga Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Integritet Evropian rreth punës dhe aktiviteteve nga viti paraprak;
4. Të ndryshme:

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Procesverbali miratohet një zëri pa asnjë vërejtje nga të gjithë anëtarët e Komitetit..

II. Raporti i ZLK-së:

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinović, Udhëheqës i ZLK-së, raportoj për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve. Ai tha se zyra që udhëheq ai, gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riadhesuar, kemi pas një rast të braktisjes së mësimin të detyrueshëm nga një nxënës i Komunitetit Ashkali.

Njoftimi për këtë rast na ka ardhur përmes shkresës Nr. Prot. 1710/02 nga SH.F.M.U "Maxhun Çekaj" Irzniq.

Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-ja kërkoj të njoftohet se si janë mundësit që ky nxënës ti kthehet procesit të rregullt mësimorë.

E njëjta u njoftua se SH.F.M.U "Maxhun Çekaj" në Irzniq përmes mekanizmave përkatës "Këshillit për Parandalimin dhe Braktisjen" e mësimin të nxënësve nga shkollat ka bërë të gjitha përpjekjet që nxënësi i lartcekur të kthehet në mësim të rregullt por pa sukses.

Ky problem do të adresohet më tutje në instancat më të larta deri sa të arrihet një zgjidhje.

III. Informim nga Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Integritet Evropian rreth punës dhe aktiviteteve nga viti paraprak:

Sa i përket raportit nga Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Integritet Evropian rreth punës dhe aktiviteteve nga viti paraprak : të njëjtin e para të pranishmeve e paraqiti z. Artan Ismajlaj Zyrtar i Lartë për Integritet Evropian.

Raporti njëvjeçar Janar-Dhjetor 2023 kaloi pa asnjë kundërshtim.

Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-ja njoftoj te pranishmit se ka kërkuar qe të raportohet për punën e Komitetit për Komunitete dy (2) here në vit çdo gjashtë (6) muaj para Kuvendit Komunal të Deçanit, propozim i cili është pranuar nga KK Deçan.

E njëjta gjithashtu propozoj qe ti drejtohet një kërkesë zyrës përkatëse pranë KK Deçan qe në të ardhmen festat e komunitetit jo shumice të shënohen me ndonjë ceremoni apo aktivitet rasti.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z, Shkelzen Berisha kërkoj nga të pranishmit që vizitat e parapara për këtë vit në vendbanimet e komunitetit jo shumicë të realizohen në të njëjtën ditë që mbahen mbledhjet e Komitetit për Komunitete .

Propozimi u miratua me shumice votash.

Kryesuesi i falënderoi të pranishmit dhe shpalli mbledhjen të mbyllur.

Procesmbajtësi:

Artan Ismajlaj



Kryesuesi i mbledhjes

Shkelzen Berisha





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Komiteti për Komunitete
02. Nr. III
Deçan, dt. 15.03.2024

PROCESVERBAL

Mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 15.03.2024.
Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.
Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës të këtij takimi.

Për mbledhje ishin propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raport nga ZLK;
3. Raport nga Drejtoria Komunale për Arsim rreth gjendjes aktuale me vijueshmërinë e nxënësve të komunitetit jo shumicë në shkolla.
4. Të ndryshme:

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Procesverbali miratohet njëzëri, pa vërejtje.

II. Raporti i ZLK-së:

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinović, Udhëheqës i ZLK-së, raportoj për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve. Ai tha se zyra që udhëheq ai, gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riadhesuar.

III. Raport nga Drejtoria Komunale për Arsim rreth gjendjes aktuale me vijueshmërinë e nxënësve të komunitetit jo shumicë në shkolla.

Sa i përket raportit nga Drejtoria Komunale për Arsim rreth gjendjes aktuale me vijueshmërinë e nxënësve të komunitetit jo shumicë në shkolla, nga kjo Drejtori ishte prezent zyrtari z. Ramiz Bajramaj i cili i njoftoj të pranishmit se këtë vit kemi një rast të braktisjes së shkollimit të detyrueshëm.

Përkundër të gjitha përpjekjeve që janë bërë nga shkolla ku nxënësi i lartcekur ka vijuar mësimet SH.F.M.U "Maxhun Çekaj" Irzniq, vizita të vazhdueshme në familjen e nxënësit me qëllim të kthimit në procesin e rregullt mësimor kanë rezultuar të pasuksesshme.

Nga të pranishmit u propozua që të organizohet një fushatë vetëdisuese neper shkollat e Komunës së Deçanit rreth kësaj problematike (braktisjes së shkollimit të rregullt).


IV. Të ndryshme:

Adem Çeku Zyrtar policor për komunitete njoftoj për aktivitetet e rregullta të institucionit që ai përfaqëson, i njëjti shprehi gatishmërinë që Policia e Kosovës të jetë pjesë e fushatave ndërgjegjësuere për komunitetin jo shumice.

Kryesuesi i falënderoi të pranishmit dhe shpalli mbledhjen të mbyllur.

Procesmbajtësi:

Artan Ismajlaj



Kryesuesi i mbledhjes:

Shkelzen Berisha





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Komiteti për Komunitete
02. Nr. IV
Deçan, dt. 12.04.2024

PROCESVERBAL

Mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 12.04.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës të këtij takimi.

Për mbledhje ishin propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raport nga ZLK;
3. Të ndryshme:

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Procesverbali miratohet njëzëri, pa vërejtje.

II. Raporti i ZLK-së:

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinović, Udhëheqës i ZLK-së, raportoj për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve. Ai tha se zyra që udhëheq ai, gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar, ka pas kërkesa për vërtetime të personave të riatdhesuar.

Pjesëtarët e komuniteteve gjatë këtij muaji kanë përfituar ndihma ushqimore dhe higjienike nga Qendra për Punë Sociale dhe shoqatat humanitare me rastin e festes së Fiter Bajramit.

III. Të ndryshme:

Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-ja kërkoj të njoftohet se kur planifikohet të dilet për vizitë komuniteteve në terren.

U propozua që javës tjetër të dilet në teren dhe të vizitohen vendbanimet dhe shkollat në vendbanimet ku jetojnë komuniteti jo shumicë.

Kryesuesi i falënderoi të pranishmit dhe shpalli mbledhjen të mbyllur.

Procesmbajtësi:

Artan Ismajlaj

Kryesuesi i mbledhjes:

Shkelzen Berisha